




KODI I ETIKËS SË MËSUESIT

NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR PUBLIK DHE PRIVAT



Funded
by the European Union



EUROPEAN UNION



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

PROJECT AGAINST CORRUPTION IN ALBANIA (PACA)

Ky manual është hartuar në kuadrin e Projektit Kundër Korrupsionit në Shqipëri (PACA), implementuar nga Këshilli i Evropës me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Pikëpamjet e shprehura në të nuk duhet të interpretohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë mendimin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Miraturar nga Ministrja e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, Znj. Lindita Nikolla, më 30 Nëntor 2013.

HYRJE

Mjedisi *arsimor, në harmoni me atë komunitar*, mund të jenë faktorë mbështetës dhe motivues të të nxënit vetëm nëse kanë në themel vlerat e parimet, të cilat ato synojnë dhe përpiqen t'i rrënjosin.

Këto vlera e parime gjenden të shprehura qartë në Kushtetutën e Shqipërisë, në legjislacionin për arsimin, në dokumentet bazë në të cilat është formuluar politika e arsimit, si: Ligji për arsimin parauniversitar, korniza kurrikulare, strategjia e arsimit parauniversitar e të gjitha dokumentet kurrikulare.

Këto vlera e parime duhet të qëndrojnë në themel të funksionimit të procesit arsimor dhe të gjithë mjedisit shkollor e komunitar që e mundëson këtë proces.

Parimet që drejtojnë procesin e arsimimit bazohen në vlera universale që janë garanci për rrugën në të cilën duhet të zhvillohet arsimi, të tilla si: drejtësia, paanësia, mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë, dinjiteti, etj.

Kodi i etikës është hartuar për të ndihmuar që mësuesit të marrë vendimet e duhura në rastet e dilemave etike me të cilat ai përballet gjatë ushtrimit të profesionit të tij dhe si agjent i veprimit komunitar.

Kodi i etikës së mësuesit ofron modelin e sjelljes që shoqëria vlerëson dhe kërkon si të nevojshëm në mënyrë që shkolla të mund të realizojë misionin e saj shoqëror, për një shoqëri demokratike.

PARIMET THEMELORE

Parimet bazë mbi të cilat hartohet kodi i etikës së mësuesit janë:

1. Parimi i **përkushtimit ndaj nxënësit**, mbi bazën e të cilit përcaktohen sjelljet që priten nga mësuesi në lidhje me procesin e të nxënët.
2. Parimi i **përkushtimit ndaj profesionit**, mbi bazën e të cilit përcaktohen sjelljet që priten nga mësuesi për përsosjen e cilësive të tij personale në funksion të të nxënët dhe të **mjedisit arsimor** që e mbështet atë në të gjitha drejtimet.
3. Parimi i **përkushtimit ndaj komunitetit** për krijimin e një mjedisi më motivues për arsimin.

Mësuesi merr përgjegjësinë t'i përkushtohet nxënësit dhe profesionit dhe komunitetit, të jetë mishërim i standardeve më të larta etike dhe model i sjelljes, që buron prej tyre.

QËLLIMI

Qëllimi i kodit të etikës së mësuesit është:

- të ndihmojë mësuesin dhe punonjësit e tjerë të arsimit për të njohur, për të kuptuar dhe për të zbatuar standardet etike të nevojshme për realizimin e misionit të arsimit dhe për të marrë vendime në kuadrin e realizimit të këtij misioni;
- të ndihmojë mësuesin dhe punonjësit e tjerë të arsimit në krijimin e një mjedisi motivues për të nxënët;
- të ndihmojë organet vendimmarrëse, në nivel qendror, vendor e komunitar, në hartimin e politikave dhe të veprimtarive që krijojnë mjedise motivuese të nxënët;
- të unifikojë standardet etike në fushën e arsimit në nivel kombëtar;
- të nxisë mësuesit në krijimin e një mjedisi motivues për komunitetin.

FUSHAT E VEPRIMIT

Kodi i etikës është i zbatueshëm në të gjitha rastet e trajtimit të dilemave etike me të cilat përballet mësuesi dhe punonjësi i arsimit. Si i tillë, ai është i zbatueshëm:

- *për mësuesin* që ushtron profesionin me kohë të plotë ose të pjesshme në institucionet publike ose private të sistemit arsimor parauniversitar të krijuara sipas legjislacionit shqiptar;
- *për personelin drejtues e ndihmës* të institucioneve publike ose private të sistemit arsimor parauniversitar;
- *për punonjësit* e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe institucioneve të saj të varësisë, në kuadër të realizimit të misionit të tyre në fushën e arsimit.

Për qëllimet e këtij kodi të etikës, termi “mësues” përfshin të gjithë individët që përmenden në pikat 1-3 më sipër.

Parimet themelore të kodit të etikës së mësuesit konkretizohen në një sërë sjelljesh etike që lidhen me larminë e marrëdhënieve që krijohen në fushën e arsimit.

Kodi i etikës nuk merr përsipër të trajtojë çdo rrethanë të mundshme në të cilën mësuesi përballet në mjediset arsimore. Ai synon të ofrojë standardet etike bazë që mund të përdoren nga mësuesi në rrethanat ku mund të ndodhet.

PËRKUSHTIMI NDAJ NXËNËSIT DHE PROCESIT TË TË NXËNIT

Shkolla dhe profesioni i mësuesit kërkojnë që mësuesi, në vendimmarrjet e tij profesionale në ushtrimin e profesionit, të ketë përparësi cilësinë e të nxënësit, mirëqënie dhe sigurinë e nxënësit.

Zbatimi i sjelljeve që burojnë nga parimet e mëposhtme krijojnë modelin e mësuesit që vlerëson si parësor interesin më të mirë të nxënësit dhe të të nxënësit të tij.

Mësuesi i përkushtohet të gjithë nxënësve njëloj dhe ushqen potencialin qytetar, shoqëror, intelektual, emocional dhe fizik të tyre.

1. Mësuesi beson në suksesin e çdo nxënësi dhe siguron kushtet e të nxënësit për të gjithë.
2. Mësuesi nxit dhe motivon të gjithë nxënësit për zhvillimin e plotë të potencialit të tyre intelektual, fizik, emocional, shoqëror e qytetar.
3. Mësuesi njeh, kupton parimet e vlerësimit dhe i zbaton ato saktësisht, në mënyrë të ndershme, të paanshme e jo diskriminuese në praktikën e tij profesionale.
4. Mësuesi vlerëson nxënësit në bazë të kriterëve të pranuar të vlerësimit dhe regjistron e raporton rregullisht të interesuarit (nxënësit, prindërit, shkollën etj) për arritjet dhe progresin e tyre.
5. Mësuesi përpiqet të ofrojë më të mirën e mundshme profesionale për nxënësit e tij dhe pranon kontributin e tyre në procesin e krijimit dhe të përvetësimit të njohurive.

6. Mësuesi i ndihmon nxënësit të vlerësojnë identitetin e tyre, të mësojnë më shumë rreth trashëgimisë së tyre kulturore dhe të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre qytetare dhe shoqërore.
7. Mësuesi trajton të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe me respekt, në përputhje me ligjin, me dinjitetin dhe vlerat e tyre të brendshme.
8. Mësuesi lufton sjelljet dhe praktikatat e pandershme, korruptive e të paligjshme që bien ndesh me këtë kod dhe angazhohet për standarde të larta etike në marrëdhënie me nxënësit.
9. Mësuesi është model i sjelljes dhe i zgjidhjeve paqësore në marrëdhëniet me nxënësit dhe të gjithë të tjerët.
10. Mësuesi njeh të gjitha format e mundshme të dhunës (fizike, psikologjike, etj.) ndaj nxënësve, brenda dhe jashtë mjedisit arsimor, dhe i shmang e i lufton ato së bashku me nxënësit.
11. Mësuesi njeh, kupton dhe zbaton parimet e përgjithshme të Konventës së të drejtave të fëmijës, në mënyrë të veçantë, parimin e interesit parësor të fëmijës dhe atë të trajtimit të barabartë të tij.
12. Mësuesi trajton me respekt dhe mirëbesim çdo informacion personal dhe të ndjeshëm për nxënësin dhe nuk e bën atë publik, nëse një gjë e tillë nuk i kërkohet nga ligji.
13. Mësuesi është i vetëdijshëm për kufijtë e tij profesionalë në marrëdhëniet me nxënësit dhe respekton ato në mjedisin arsimor.

PËRKUSHTIMI NDAJ PROFESIONIT, NJË MJEDISI MBËSHTETËS DHE BASHKËPUNUES TË NXËNI

Mësuesi i përkushtohet zhvillimit dhe vetëzhvillimit profesional në mënyrë që të zhvillojë praktikën e mësimdhënies.

1. Mësuesi pranon, respekton dhe zbaton parimin e partneritetit mësues-nxënës në procesin e të nxënës.
2. Mësuesi reflekton vazhdimisht për procesin e mësimdhënies, angazhohet në mënyrë sistematike në vetëzhvillimin profesional dhe merr pjesë aktive në procesin e kërkimit shkencor në shërbim të ruajtjes dhe përmirësimit të praktikës së mësimdhënies.
3. Mësuesi nxit dhe mbështet kolegët e tij për arritjen, ruajtjen dhe zhvillimin e standardeve të larta në arsim.
4. Mësuesi merr pjesë në vendime që kanë të bëjnë me kurrikulën, mësimdhënien e vlerësimin dhe ndan me drejtuesit përgjegjësitë e tij për drejtimin e shkollës.
5. Mësuesi bashkëpunon me komunitetin për pasurimin e mjedisit të shkollës dhe të burimeve në shërbim të të nxënës.
6. Mësuesi respekton kolegët e tij të rinj dhe ata me më pak përvojë, si dhe parimin, se të gjithë kanë të drejtë të japin mësim e të nxënë në një mjedis motivues, mbështetës e profesional.
7. Mësuesi mbështet dhe merr pjesë në përgatitjen dhe në trajnimin e mësuesve të rinj, si dhe në zhvillimin profesional të të gjithë stafit.

PËRKUSHTIMI NDAJ KOMUNITETIT

Mësuesi i përkushtohet komunitetit për krijimin e një mjedisi më motivues për arsimin.

1. Mësuesi jeton në komunitet dhe për të. Ai ka në qendër të interesit të tij kthimin e shkollës, gjithnjë e më shumë, në qendër komunitare.
2. Mësuesi bashkëpunon me prindërit dhe anëtarë të tjerë të komunitetit jo vetëm për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies e të nxënësve, por edhe për të zgjeruar gamën e shërbimeve edukative që shkolla mund të ofrojë në komunitet.
3. Mësuesi pranon që trashëgimia gjuhësore dhe kulturore, familja dhe komuniteti modelojnë marrëdhëniet e shkollës me komunitetin.
4. Mësuesi informon rregullisht komunitetin për punën dhe arritjet si dhe për nevojat dhe çështjet në interes të përbashkët.

UDHËZUES PËR ZBATIMIN E KODIT TË ETIKËS

Etika ka të bëjë me filozofinë që studion motivet njerëzore në bazë të parimeve të së drejtës dhe së gabuarës. **Kodet e etikës** kanë në bazë parimet dhe vlerat, të cilat, të harmonizuara, përbëjnë strukturën tonë etike që mund të ndikojë në sjelljen tonë, vendimet që marrim dhe mënyrën tonë të jetesës. Kodet e etikës shpallin parimet e përgjithshme (morale ose sociale) që më shumë drejtojnë dhe jo diktojnë sjelljen.

Kodi i etikës është një përpjekje e bërë nga një organizatë ose institucion, në rastin tonë institucionet arsimore, për të kodifikuar vlerat e përbashkëta të tij/saj.

Kodi i etikës së mësuesit në vendin tonë, shpall parimet themelore, që lidhen me misionin e arsimit. Ato ndihmojnë punonjësit e arsimit të zgjedhin çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar në të gjitha vendimmarrjet e bëra në kuadrin e veprimtarisë së tyre. Në këtë mënyrë, kodi i etikës synon të nxisë standardet më të larta etike në tërë sistemin arsimor dhe të bëjë të njohur vlerat dhe pritshmëritë e këtij sistemi për tërë punonjësit e vet.

Të gjitha institucionet arsimore kanë si detyrë:

- Të mirinformojnë dhe të trajnojnë të gjithë stafin mësimor për parimet dhe qëllimin e kodit të etikës.
- Të nxisin angazhimin dhe përkushtimin ndaj këtij kodi të të gjithë punonjësve të arsimit (mësues, drejtues, nxënës, etj.).

- Të përkthejnë kodin e etikës në udhëzime, rregullore, etj. për sjelljet që duhen krijuar e mbështetur, në kushtet e veçanta të mjedisit të tyre arsimor.
- Të ofrojnë shembuj konkretë për zbatimet në praktikë të kodit të etikës.

Sjelljet që vijnë në kundërshtim me parimet e sjelljet e mësipërme gjykohen vetëm në përputhje me legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës në përgjithësi dhe ato që lidhen me fushën e arsimit, si: Kodi i Punës, Ligji për arsimin parauniversitar, Dispozitat normative në arsim dhe kontrata kolektive e punonjësve të arsimit. Asnjë autoritet tjetër nuk mund të zëvendësojë autoritet e mësipërme ligjore.

Komisioni i etikës dhe i sjelljes, i përbërë nga mësues, prindër dhe nxënës, që funksionon në institucionin arsimor (neni 33 i Ligjit për arsimin parauniversitar) ka për detyrë të shqyrtojë ankesat e nxënësve, të prindërve e të punonjësve të institucionit, për sjellje që mendohen jo në përputhje me parimet e këtij kodi dhe e fton punonjësën për sqarim dhe këshillim.

Ky komision i propozon drejtuesit të institucionit për shqyrtime dhe veprime të mëtejshme, në rastet kur sjelljet në fjalë konsiderohen shkelje të ligjit ose të dispozitave ligjore.

Të gjitha masat ndaj mësuesit merren vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nga institucionet përkatëse.



KODI I ETIKËS SË MËSUESIT

NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR
PUBLIK DHE PRIVAT

Ky botim u realizua me mbështetjen financiare të Këshillit të Evropës dhe në bashkëpunim me Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit.

